

02 Nr. Dr. 600/01-11968/24

24.06.2024

Dragash - Dragash



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 24.06.2024

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë për

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027

I mbajtur më 18.06.2024 (e martë)

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj, dhe komunitete joshumicë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 28.05.2024.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-1.pdf>

Bosnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-2.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/JN6ZcTkFeXhF3djE/>

Bosnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/2iU5ACD7YRQs76vk/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-3-2.pdf>

REPUBLICA FEDERATIVA
BRASILEIRA
KOMITE E DIRETORIA
O Poder Popular

Brasília - DF

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **22 pjesëmarrës, prej tyre 18 meshkuj dhe 4 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Qamil Kolloni.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në këtë Dëgjim buxhetor! Në qoftë se më lejohet të filloj për Kornizën Afatmesme Buxhetore. KAB-i është program të cilin Qeveria e Kosovës, me ligjin e saj, e parashev në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës. Në bazë të Qarkores së Parë Buxhetore të cilën ua shpërndan komunave, përcakton limitet, apo më mirë me thënë kriteret për shpenzimet e buxhetit gjatë viteve 2025-2027. Si Komunë, kemi marrur me kohë Qarkoren Buxhetore dhe i kemi analizuar të gjitha kriteret të cilat janë të përcaktuara për shpenzimet në kuadër të KAB-it. Prandaj, për kët periudhë të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2025 buxheti preliminar i Komunës së Dragashit është si në vijim: Granti i Përgjithshëm është 7,135,000 euro; Granti Specifik për Arsim është 3,705,000 euro; Granti Specifik për Shëndetësi është 1,480,000 euro. Gjegjësisht, buxheti në përgjithësi përmban 12,321,000 euro, si grant nga Qeveria. Kurse, të hyrat vetanake për vitin 2025 janë paraparë në vlerën prej 551,000 euro. Në total, buxheti preliminar është në vlerë prej 12,872,000 euro. Në bazë të Qarkores, kemi një rritje prej 8% të buxhetit, në krahasim me vitin 2024. Kurse, ndarjen në programe për të gjitha drejtoritë, besoj se do të na marrë shumë kohë sikur ta analizojmë, ne do të shkojmë t'i bëjmë ndarjet kryesore. Atëherë, më lejoni që paraprakisht të ju njoftoj se cila është vlera e përgjithshme e shumës për investime kapitale për vitin 2025. Sipas KAB-it, për vitin 2025 kemi këto shpenzime: Paga dhe Méditje kemi 5,844,000 euro; Mallra dhe Shërbime kemi 1,513,000 euro; Shpenzime Komunale kemi 400,000 euro; Subvencione kemi 400,000 euro; dhe Investime Kapitale kemi 4,714,000 euro. Gjegjësisht, 12,872,000 euro është në përgjithësi buxheti. Sa i përket Grantit të Përgjithshëm, duhet ta dini se ne kemi edhe grantin specifik i cili ndahet për arsim, dhe rrrok vlerën 3,705,000 euro, dhe grantin specifik 1,480,000 euro. Për investime kapitale janë paraparë projektet nëpër të gjitha fshatrat. Në qoftë se jeni të interesuar, ne mund edhe t'i lexojmë. Në përgjithësi projektet për vitet 2024-2025. E di që shumica jeni të interesuar për projektet nëpër fshatra, prandaj po fillojmë me i paraqit të gjitha këto projekte të cilat i kemi planifikuar që të realizohen gjatë viteve 2024-2025:

1. Ndërtimi i Impiantit për pastrimin dhe filtrimin e ujit në Lumin e Radeshës, janë paraparë mjete për vitin 2025, 382,000 euro dhe 230 mijë euro kanë qenë të parapara për vitin 2024;
2. Ndërtimi i rrugëve në qytezën e Dragashit, Ruga “Sheshi i Dëshmorëve” dhe Rruga Unazore në Dragash - 105,935 euro për vitin 2025;

3. Kubëzimi i rrugëve te varrezat në fshatin Zaplluxhe, mahallët Rrenak, Tumqinë dhe mahalla te Xhamia – 100,000 euro për vitin 2025;
4. Kubëzimi i rrugëve “Livadhi i Begit” dhe Kodrat, dhe hapja e rrugës te Ura e Hoxhës në fshatin Blaç – 22,000 euro;
5. Ndërtimi i parkut në Rrugën “Skender”, Mahalla Prifte në fshatin Blaç – 50,000 euro;
6. Rregullimi i ujëmbledhësit dhe i kanalizimit në vendin “Gjybra e Pashës” në Blaç – 50,000 euro;
7. Ndërtimi i parkut dhe këndi i lojërave përfëmijë te Xhamia, dhe rregullimi i rrrethojës së parkut tek Mahalla e Epërme e fshatit Blaç – 300,000 euro;
8. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Luftëtari i Lirisë”, Rruga “Zgatar” dhe Rruga e Imamajve, ndërtimi i murit mbrojtës Rruga “Danaj” dhe rregullimi i parkut në qendër të fshatit Bresanë, për shpronësim – 271,939 euro (pra, disa projekte janë të përbledhura në një);
9. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kuklibeg – 50,000 euro;
10. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg – 30,000 euro;
11. Ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Kuk – 7,000 euro;
12. Kubëzimi në rrugët “Samidin Emini” dhe “Shelqja e Drugës” në fshatin Kuk - 87,118 euro;
13. Hapja dhe trasimi i rrugës Kuk – Kosavë – 15,000 euro;
14. Kubëzimi i rrugës qendrore në fshatin Buzez – 69,000 euro;
15. Hapja e kanalit dhe rregullimi i ulësve dhe trotuarit deri në Mejdan në fshatin Kosavë – 97,555 euro;
16. Ndërtimi i murit mbrojtës te Rruga e Xhamisë në fshatin Kosavë – 33,000 euro;
17. Asfaltimi i rrugës Kapre – Rrenc – 200,000 euro;
18. Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatin Kapre – 40,000 euro;
19. Kubëzimi dhe ndërtimi i murit mbrojtës në rrugët “Kuji i Mullinit” dhe “Prroni i Serdarit” në fshatin Zgatar – 90,000 euro;
20. Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Rrugën “Ograde” në fshatin Brrut – 7,000 euro;
21. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Brrut - 2,000 euro;
22. Hapja e rrugës te Likeni në fushën e fshatit Brrut – 40,000 euro;
23. Ndërtimi i rezervuarit të ujit në vendin “Kroi i Madh” në fshatin Bellobrad – 25,000 euro;
24. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Bellobrad 70,000 euro;
25. Kubëzimi i rrugëvës në rrugën e xhamisë, ndërtimi i murit mbrojtës në Qollopek dhe kanalizimi nga Lugu i Pulës në fshatin Zym – 70,000 euro;
26. Ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza në Rrugën e Mullinit në fshatin Brezne – 330,000 euro;

27. Kubëzimi i rrugëve “Pirkuqi”, “Kroi i Dhive” dhe “ Hani i Llopushnikut” në fshatin Brezne – 45,645 euro;
28. Kubëzimi i rrugëve “Adem Berisha”, “Beteja e Buqes” dhe “Qereza” në fshatin Buqe – 70,000 euro;
29. Ndërtimi i stadiumit në fshatin Plaavë – 70,000 euro;
30. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Plavë – 20,000 euro;
31. Ndriçimi publik në qendër të fshatit Plavë – 20,000 euro;
32. Ndërtimi i Prronit në Rrugën “Kreveqica” në fshatin Plavë – 8,500 euro;
33. Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i mureve mbrojtëse në Rrugën “Abdyrrahman Gërdellaj” në fshatin Rrenc – 70,000 euro;
34. Ndërtim i rrugës Xërxe-Rrenc në fshatin Xërxe – 30,000 euro;
35. Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Pllajnik – 45,000 euro;
36. Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Shajne – 120,000 euro;
37. Ndërtimi i infrastrukutrës rrugore në fshatin Kukajan – 50,000 euro;
38. Kubëzimi i rrugës në Rrugën “Peto Mahalle – Shokovce”, likeni dhe rregullimi i Prronit nga “Gjonjet” në fshatin Brod – 180,000 euro;
39. Ndërtimi i parkut në fshatin Dikancë – 40,000 euro;
40. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Baçkë”, varrezat në fshatin Baçkë – 50,000 euro;
41. Ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Leshtan – 50,000 euro;
42. Kubëzimi i rrugëve në qendër të fshatit Radeshë – 90,000 euro;
43. Ndërtimi i murit mbrojtës, parkingu në fshatin Kërstec – 80,000 euro;
44. Hapja e pusit në vendin “Brod” dhe rregullimi i ujësjellësit në vendi “Barbulla” në fshatin Glloboqicë – 123,000 euro;
45. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Krushevë – 130,000 euro;
46. Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve, si dhe rregullimi i Prroit në fshatin Vraniçë – 70,000 euro;
47. Ndërtimi i Prronit, renovimi i fushës së sportit në fshatin Rapçë – 130,000 euro;
48. Ndërtimi i murit dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Orquashë – 30,000 euro;
49. Kubëzimi i rrugës dhe ndërtimi i kanalizimieve në fshatin Zlipotok – 90,000 euro;
50. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Llukov” në fshatin Restelicë – 260,000 euro;
51. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Libevishtë – 70,000 euro;
52. Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Mlikë – 40,000 euro;

53. Ndërtimi i Shtëpisë për Personat me Aftësi të Kufizuara – është paraparë gjatë këtij viti;
54. Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç – 100,000 euro;
55. Ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse në Dragash – 185,000 euro;
56. Ndërtimi i pllakës dhe kulmit, si dhe renovimi i SHFMU “28 Nëntori” në fshatin Bresanë – 21,745 euro;
57. Renovimi i Shkollës Fillore në fshatin Restelicë – 60,000 euro;
58. Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë në Shkollën Fillorë “28 Nëntori” – 30,000 euro;
59. Ndërtimi i rrugës dhe oborrit të Shkollës Fillore “Ulina” në Kosavë – 3,000 euro;
60. Ndërtimi i nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash – 40,000 euro.

Pra, këto janë ndarjet buxhetore për investime kapitale për vitin 2025. Janë ndarje preliminare, këto deri në shtator mund të pësojnë edhe ndryshime, po realisht mund të pësojnë ndryshime të vogla. Ka mundësi të kemi edhe shtim të buxhetit, të kemi edhe projekte të reja. Njëkohësisht, varësisht prej fshatrave dhe ndonjë propozim tjetër që mund të vijë ndërkokë, mund t'i orientojmë edhe në projekte të ndryshme. Sa për fillim, kjo është ajo pjesa e investimeve kapitale të cilat janë paraparë për vitin 2025.

Bexhet Xheladini: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë debat publik! Unë vetëm deshta të ndërhyj pak te planifikimet buxhetore që i kemi bërë. Këto planifikime i kemi bërë në bazë të kërkesave që i kemi marrë nga kryesitë e fshatrave dhe nga debatet publike që i kemi pas para këtij debati të fundit. Nga Asambleja Komunale e cila do të mbahet më datën 28 të këtij muaji, do t'i miratojë këto propozime të buxhetit. Por, ky do të jetë një vendim preliminar i Asamblesë Komunale. Do të ketë kohë që të bëhen ndryshime të këtij buxheti, edhe sa i përket shumë dhe ndarjeve buxhetore, por edhe sa i përket orientimit të këtyre mjeteve nëpër projekte të ndryshme. Deri në shtator, edhe pse ky është debati i fundit me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025, megjithatë Ligji për Menaxhimin e Financave Publike e parashev që deri në shtator qytetarët mund të vijnë me kërkesa të ndryshme për të hequr ndonjë projekt, për të vu ndonjë projekt të ri etj. Unë më shumë nuk dua të ju marr kohë. Nëse ka dikush nga ju që do me e marrë fjalën, le të urdhërojë!

Senat Trupaj, fshati Kosavë: Faleminderit! I nderuar kryetar i Komunës, i nderuar drejtor për Buxhet dhe Financa, e nderuar drejtoreshë e DKRS-së, të nderuar të pranishëm! Më lejoni që të

parashtroj një kërkesë. I nderuar kryetar i Komunës, unë, në emër të të rinxve të fshatit Kosavë, ju drejtoshem me këtë Kërkesë për ndërtimin e një stadiumi në fshatin Kosavë. Fshati ynë, i cili është njëri nga të paktët që ende nuk ka një stadium, është i njojur për sukseset e vazhdueshme në sport. Të rinxjtë tanë kanë arritur të zënë vendin e parë thuajse në çdo turnir të organizuar, dhe emrat e shumë lojëtarve nga fshati ynë janë të njojur për kontributin e tyre të madh në futbollin komunal dhe më gjerë. Pavarësisht këtyre arritjeve, mungesa e një stadiumi lokal është sfidë e madhe për të rinxjtë tanë, të cilët shpesh janë të detyruar të udhëtojnë në vendet tjera për të zhvilluar talentet e tyre. Ndërtimi i një stadiumi në fshatin Kosavë do të ishte një investim i madh në të ardhmen e sportit dhe të rinxve tanë, duke u mundësuar atyre një ambient të përshtatshëm dhe të sigurt për zhvillimin e aftësive të tyre. Ne besojmë se ky projekt do të ketë një ndikim pozitiv jo vetëm për sportistët e ri, por edhe për të gjithë komunitetin tonë, duke forcuar lidhjet shoqërore dhe duke nxitur një stil jetese të shëndetshëm. Shpresoj në mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj për realizimin e kësaj Kërkeze!

Sabahat Hasani, fshati Zgatar: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndes së pari kryetarin, së bashku me Kabinetin e vet! Prezantoj sot komunitetin e fshatit Zgatar. Edhe herën e kaluar ky komunitet ka kërkuar që të bëjë rrëthimin e varrezave të reja të fshatit Zgatar. Nuk e di a është marrë në shqyrtim apo jo. Andaj, si kërkesë primare e komunitetit është rrëthimi i varrezave të reja të fshatit. Kërkesa kemi shumë të tjera, mirëpo duke e ditur buxhetin se sa është e si është dhe ndarjet që janë bërë, nuk vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

Jeton Qengaj, OJQ “AVOKO”: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje për kryetarin dhe Kabinetin! Është kënaqësi të kem këtë rast, për herë të parë po e marr guximin që të dalë të foli për Dragashin. Edhe pse, si çdo kryetar, në një formë ose tjetër janë munduar me punue dhe ndoshta edhe kanë bërë një punë të mirë. Por, çështja e Komunës së Dragashit nuk është marrë asnjëherë serioze, duke e marrë parasysh se Dragashi është një qendër. Të gjithë kanë ngarë për fshatrat. Sido që të jetë, nëse shkojmë prej Zaplughes për në Bresanë, duhet me kapërcye nëpër fshatra tjerë. Po Dragashi pak është lënë anash. Nuk do të hyj për këto që janë në investim e të tjera, por shumë thjesht do të vijë me disa pikë të vogla. Është një problem që në Komunën e Dragashit, linjat e autobusit prej Opojës dhe Gorës për Dragash. Me të vërtet Komunën e Dragashit e kanë lënë mbrapa, duke mos pas mundësi linjat e autobusit për me ardhë. Nëse ne bashkarisht e ndërmarrim për vitin tjetër një buxheti, t'i subvencionojmë disa linja të autobusit për me i pru në

Dragash – vetëm në ora 08:00 e kemi një linjë, e për Prizren i kemi 20 linja – nëse ne e ndajmë një buxhet dhe i biem për Dragash dy-tri linja, më besoni që do ta ngjallim Dragashin. Sepse, të paktën do ta ketë një hapësirë një i ri në Dragash për me ardhë me e pi një kafe, e jo me shkue në Prizren. Nuk e di a e keni diskutue këtë pikë dhe a është mundësia për me e bo këtë. E dyta: Si zakonisht, gjithmonë ne për Bajram e kemi atë të mirën me i pastrue oborrat tonë dhe mbeturinat me i lënë jashtë, po nëse ne nuk e kemi qendrën e mirë, ne nuk i kemi edhe fshatrat e mirë. Pastaj, është shumë kënaqësi me i pa mbjelljen e lulave në Komunë të Dragashit. Nuk e di ajo kompani që i ka mbjellë, a e ka për mirëmbajtjen dhe ujitjen. Nëse nuk e ka ujitjen, atëherë duhet të caktohet një përgjegjës. Nëse s'keni mundësi ju me e caktue një përgjegjës, unë e marr përsipër, dal vetë i ujiti. Po vetëm me u mbjellë lula dhe me u lënë me atë gjendje, nuk është e pranueshme, sepse ato po thahen. Pastaj është edhe një problem tjetër: Nuk jam kundër këtyre trafikave që janë në Dragash, është shumë mirë me krijue vende të punës, bile edhe me i subvencionue – po të paktën ta bëjmë një kriter, t'i përshtatim një vendi turistik dhe t'i bëjmë ato trafikat me dru, e ta rregullojmë pak, se me të vërtet qendra e Dragashit, nganjëherë kur hyjmë në Dragash na doket vetja shumë katastrofale. Ky nuk është problem i sotit, por është qe 24 vite. Nëse ne duam pak me e ngjallë këtë Dragash, pika kryesore e Dragashit është që të ketë linja të autobusit prej Opojës për në Dragash, edhe prej Gorës njëjtë. Pastaj, është një problem te stadioni i Graniçarit, me u rregullue infrastruktura, e kemi edhe një pjesë të malit, pjesë të brendshme shumë të mirë që duhet të bëhet me staza të ecjes. Jo me kubëzim, të jetë natyral, po vetëm vendosja e dritave aty do të ishte shumë një kënaqësi, se në mbrëmje ka shumë njerëz që shkojnë dhe e vizitojnë. Ka edhe pika të tjera, po sot nuk do të flas shumë, po të paktën këtë kërkesën për linjat e autobusëve, po të flas në emër të 300 të rinjve dhe mundi me t'i pru nënshkrimet që ka probleme, edhe për me e ngjallë jetën qoftë në mbrëmje pak të rinjtë, me e lënë një linjë të autobusit. Përveç se ua paguajmë transportin për aktivitete, ne po duhet me i hyp kerrit edhe me shkue me i marrë të rinjtë, se s'kanë me çka me ardhë, edhe pse kanë interesim. Përveç kësaj, tash jemi duke hap edhe shumë programe për moshën e fëmijëve, prej moshës 9-12 vjet. E kemi edhe Xhinan këtu, që është prej Korpusit të Paqes. Ka shumë mundësi në Dragash me u zhvillue, po fatkeqësisht të gjithë po ankokhem, jo fëmijët s'kanë çka me bo. Tash e kemi mundësinë, t'u sigurojmë linjën e autobusit për me ardhë në Dragash, edhe kemi me e pa që Dragashi është një vend për një jetesë shumë të mirë. Edhe pse një 30% të Komunës së Dragashit kanë ik, jetojnë në Prizren, e vijnë e punojnë këtu. Po të paktën ne këtu që jemi, të interesohemi për këtë vend, për me punue. Kaq kisha, faleminderit!

Uzair Hamza: Ju përshëndes të gjithë të pranishmëve! Unë si shef i Zyrës për Komunitetet, kam nevojë të theksoj se ndarja e buxhetit është bërë edhe për komunitetet në Komunën tonë. Dua të them pse përafërsisht, nga 4 milionë e diçka euro që janë ndarë në infrastrukturë dhe investime kapitale, 1,473,000 euro janë investuar në fshatrat e Gorës. Nuk dua të hyj në detaje se në cilat fshatra janë ndarë këto mjete. I bëj thirrje përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, zv/kryesuesit të Kuvendit dhe kryesuesit të Komitetit për Komunitete, në bazë të kërkeseve të qytetarëve që t'i japid prioritetet, ta bëjnë listën preliminare e cila nuk është përfundimtare, për nevojat e qytetarëve nëpër fshatra. Ajo që është me rëndësi dhe që dua të them, në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, ne kemi pasur sa i përket investimeve kapitale një diskriminim pozitiv. 43.57% të buxhetit për investime kapitale, kjo shifër i përket komunitetit joshumicë. Në këto investime kapitale, ka vend për ndryshime të investimeve, në bazë të bisedave me qytetarët e fshatrave.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Nëse nuk ka dikush tjetër me e marrë fjalën, atëherë unë do t'ju përgjigjem të gjithë atyre që bënë kërkesa ose pyetje. Sa i përket stacionit në fshatin Kosavë, e di që në fshatin Kosavë janë shumë projekte duke u zhvilluar, të cilat jaë dy-tri vjeçare. Ato ne duhet t'i përfundojmë. Gjithashtu, edhe një pjesë të madhe të mjeteve të Grantit të Performancës, gati gjysma do të shkojë në asfaltimin e rrugës së fshatit Kosavë. Për vitin 2025 kemi paraparë prapë mjete të tjera. Unë besoj që kërkesa e rinis së fshatit është me vend. Mirë që e bëtë kërkësen me shkrim, dhe kërkësës duhet t'i bashkëngjitet edhe sigurimi i lokacionit. A ka vend ku ndërtohet? Atëherë e vazhdojmë bisedën, se nuk është problem kur është fjala për kërkësat e rinisë, ne jemi në gjendje dhe jemi të disponimit që këto kërkesa të rinisë t'i çojmë në vend edhe t'i realizojmë. Kështu që, në këtë drejtim, sa të jam unë kryetar i Komunës, besoj që këtë kërkësë të juajën do ta realizojmë. Te rrethimi i varrezave të fshatit Zgatar, ne deri në shtator kemi mundësi që të bëjmë lëvizje. Përveç mjeteve që i kemi paraparë për kubëzime, për mure mbrojtëse, ne sot kemi shtuar edhe mjete të tjera, kështu që ka mundësi që ato mjete që i kemi shtue, t'i orientojmë në rrethimin e varrezave të fshatit Zgatar. Sa i përket linjës së autobusëve Dragash-Prizren, Ka qe një vit e gjysmë që unë kam bërë disa kërkesa në Ministrinë e Infrastrukturës. Kam qenë edhe personalisht në takim, kam bërë edhe një marrëveshje me kryetarin e Komunës së Prizrenit, ku e kanë lejue Komunën e Dragashit që, pavarësisht çfarë vendimi bjer Ministria e Infrastrukturës, Komuna e Prizrenit është e pajtimit që ne t'i fillojmë procedurat për hapjen e një linje të autobusit, sidomos në mëngjes kur vijnë punëtorët nga Prizreni në Dragash dhe në ora 15:30 kur kthehen nga Dragashi për në Prizren. Ende nuk e kemi marrë përgjigjen definitive nga Ministria, shpresojmë se së shpejti

do ta marrim një përgjigje pozitive. Para një jave kam pas një bisedë telefonike me zyrtarin kompetent, kam pas takim edhe me zv/ministrin e Infrastrukturës, edhe ai ma ka dhënë një shenjë pozitive. Besoj se kjo kërkesë do të realizohet. Sa i përket stazës për ecje, ne e kemi në projekt, kemi konkurruar në MAPL me projekt. Sipas informatave që i kam marrë ditën e premte, projekt na ka kalue, vetëm nëse nuk ndodh diçka e papritur. Gjithashtu, edhe ne mjete të Komunës kemi të ndara, sepse këto projekte bëhen me bashkëfinancim. Po ashtu, sot, gjatë përgatitjes së KAB-it, ne i kemi ndarë edhe 185 mijë euro, mjete për përfundimin e stadiumit të qytetit, këtu përfshihet edhe infrastruktura, edhe ndriçimi i asaj pjesës ku ka me u bo staza e ecjes, çuarja e rrymës deri te stadiumi, edhe ndërtimi i tribinave. Arsyja është se zhveshtorja e cila ka qenë e ndërtuar më herët, ajo do të prishet, do të bëhet zhveshtore e re dhe anash saj do të bëhen tribinat. Kështu që, ne do ta bëjmë një stadium të cilin do ta kenë lakmi jo vetëm regjioni, por edhe Kosova. Besoj që ky stadion vitin e ardhshëm do të jetë komplet i përfunduar. Sa i përket ndarjeve buxhetore që i përmendi shefi i Zyrës së Komuniteteve, ne çdo herë, para se me u përgatit buxheti, ne e ndajmë buxhetin e mjeteve të përbashkëta, pastaj e ndajmë buxhetin veç e veç për pjesën ku jetojnë shqiptarët dhe për pjesën ku jetojnë komuniteti joshumicë. Kësaj radhe prapë kemi bërë një diskriminim pozitiv, ku sot, gjatë përgatitjes së KAB-it, kemi ndarë plus 20 mijë euro për Dragash, jo nga mjetet e përbashkëta, por nga mjetet e komunitetit shumicë. Gjithashtu, kemi ndarë 185 mijë euro për ndërtimin e infrastrukturës në stadiumin e Dragashit, jo nga mjetet e përbashkëta, por nga mjetet e komunitetit shumicë. Edhe kemi ndarë 40 mijë euro për ndërtimin e nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në Shkollën e Mesme "Ruzhdi Berisha" në Dragash, prapë nga mjetet e komunitetit shumicë. Në fund, nëse bëjmë kalkulimin, del se diku afér 45% të mjeteve kemi bërë diskriminim pozitiv, sa i përket komunitetit joshumicë. Gjithashtu, duhet ta dini që edhe ministritë kanë ndarë mjete të cilat do të shpenzohen në pjesën ku jetojnë komuniteti joshumicë. 350 mijë euro janë ndarë mjetet nga MMPHI, për rrugën Zlipotok-Brod, dhe afér 2 milionë euro për rrugën e cila lidh Dragashin, Kërstecin me Shqipërinë. Këto janë mjetet të cilat i ka ndarë Ministria, e jo Komuna, po megjithatë janë mjetet të cilat shkojnë për komunitetin joshumicë. Gjithashtu, ka edhe mjetet të tjera të cilat vijnë edhe nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat bëjnë investime në pjesën ku jetojnë komuniteti joshumicë. Kështu që, në këtë drejtim, zërat të cilët nxisinurrejtje dhe pakënaqësi, janë të pabazë. Unë, prej se kam ardhë kryetar i Komunës, kam pas një kujdes të jashtëzakonshëm, që te ndarjet buxhetore, çdo herë të ketë diskriminim pozitiv në pjesën ku jeton komuniteti joshumicë.

Amra Zaimi, gazetare RTK: Mirëmbajtja e rrugeve lokale.

Bexhet Xheladini: Mirëmbajtja e rrugeve lokale bëhet me mjetet nga Mallrat dhe Shërbimet, kështu që ne mund të ndajmë mjetet të nevojshme për mirëmbajtjen e rrugeve lokale, edhe do të ndajmë, sepse e kam vërejt se gjethet dhe drunjë kanë fillue me i zënë rruget. Ne vitin e kaluar e kemi pas, këtë vit do ta shpallim prapë tenderin për mirëmbajtjen e rrugeve lokale, deri në dimër. Në dimër pastaj e kemi të rregulluar këtë çështje.

Uzair Hamza: Nëse mundem ta ndaj një informatë me qytetarët. Nuk e di a e tha kryetari, te mjetet për komunitetet, sidomos për ndriçim, kjo është një çështje shumë me rëndësi për fshatrat, e sidomos për pjesën e Gorës, sidomos fshatrat që janë rrëth kufirit, nuk kanë ndriçim dhe atje ka pasur disa incidente. Dua të them që të gjitha fshatrat që janë rrëth kufirit kanë pas probleme, në Rapçë, Brod, Zlipotok, Baçka, Dikancë, Kukajan, Leshtan. Në të gjitha fshatrat ku ka ndriçim publik, Komuna e Dragashit për herë të parë në historinë e vet ta marrë për obligim pagesën e ndriçimit, se deri më tanë qytetarët vetë janë organizuar rrëth pagesës së rrymës. Kështu që, në vitin 2025, me buxhetin e Komunës këto shpenzime të ndriçimit t'i paguajë Kuvendi Komunal. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Linjet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degimi-buxhetor-me-qytetare-gra-vajza-te-rinj-pensioniste-dhe-komunitete-joshumice/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš**

D2 Nr. Br. 400/01-119 68/24
18.06.2024



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Data/Datum: 18.06.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash / Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESEMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME
QYTETARË, GRA, VAJZA, PENSIONISTË, TË RINJ DHE
KOMUNITETE JOSHUMICË**

**LISTA UČESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA SA GRADANIMA,
ŽENAMA, DEVOJKAMA, PENZIONERIMA, OMLADINOM I
NEVECINSKIM ZAJEDNICAMA**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivališe	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	Gresa Hasani	Brojt	Shqiptare		F	Gresa H.
2	Semra Tosaku	Bregdet	Shqiptare		F	Semra T.
3	Erni Selimi	Xerxe	Shqiptar	M		Erni Selimi
4	Dardan Bayrami	Dragash	Shqiptar	M		Dardan Bayrami
5	Selad Leproj	Pllavë	Shqiptar	M		Selad Leproj
6	Semine Mbimi	Shane	Shqiptare		F	Semine Mbimi
7	Jeton Gencaj	Dragash	Shqiptar	M		Jeton Gencaj
8	Geena Richards	Dragash	America		F	Geena Richards
9	Jonot Tugay	Kosovë	Shqiptar	M		Jonot Tugay
10	Emolnit Hincay	Bllokuve	Shqiptar	M		Emolnit Hincay
11	SIBAHAT HASAKI	ZGATAR	SHQIPTAR	M		SIBAHAT HASAKI
12	DZULBEHAR TAIDI	LEŠTAKIE	ROŠTRAK	M		DZULBEHAR TAIDI
13	FLORIM KRASNIP	BREZNE	SHQIPTARE	M		FLORIM KRASNIP
14	Dremi Myrkzen	83p	Kosova	M		Dremi Myrkzen
15	VETON Haxhi	ZAPLAKUHE	SHQIPAR	M		VETON Haxhi
16	Ismail Bajrami	Shajne	Kosova	M		Ismail Bajrami
17	Abdullah Prendza	Boçje	Kosova	M		Abdullah Prendza
18	NEJIR REŠILLI	RRESJAN SHQIPTAR	M			NEJIR REŠILLI
19	KERIM FATIFI	BLOK	Shqiptare	M		KERIM FATIFI
20	FARI KOLLONY	Kosovo	Shqiptar	M		FARI KOLLONY
21	SUAD TOSUNI	PAPRJA	BOSNIAK	M		SUAD TOSUNI
22	Adem Entini	Zgjdar	Shqiptar	M		Adem Entini
23						
24						



